



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 168, datë 18.12.2020

PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE “ROVE-LUNXH”, “BALDUSHK” DHE “FAG”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 3, nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 11, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, nenit 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, vendimit nr.433, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, i ndryshuar, si dhe në vijim të memos nr. 39707, datë 11.11.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, me propozim të Kryetarit, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë planet e mbarështimit të ekonomive pyjore “Rove-Lunxh”, “Baldushk” dhe “Fag”, sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e planeve të mbarështimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pranë Ministrisë përgjegjëse për pyjet.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO